



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2912/6 prot.

Datë 31.10.2025

V E N D I M
Nr. 1567/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 31.10.2025, shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga BOE “Viante Konstruksion” SHPK dhe “Kegli-Duri” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr REF-36522-01-31-2025, me objekt: “Blerje Inerte”, me fond limit 161,080,000.00 (njëqind e gjashtëdhjetë e një milion e tetëdhjetë mijë) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 05.03.2025, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik Tiranë.

Ankimues: BOE “Viante Konstruksion” SHPK dhe “Kegli-Duri” SHPK me NIPT K47103804L dhe K94016202U dhe adresë: Elbasan, Gramsh, Sporti

Autoriteti Kontraktor: Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik Tiranë me adresë: Rruga “5 Maji” , Tiranë

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar,

Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt - ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 03-02-2025, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr REF-36522-01-31-2025, me objekt: “Blerje Inerte”, me fond limit 161,080,000.00 (njëqind e gjashtëdhjetë e një milion e tetëdhjetë mijë) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 05.03.2025, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik Tiranë.

II.2. Në datën 05-03-2025, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

II.3. Në datën 24.06.2025, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

- OUEEN shpk	107,921,000 lekë pa tvsh	skualifikuar
- BOE “VIANTE Konstruksion” shpk & “KEGLI-DURI shpk”	107,979,600 lekë pa tvsh	skualifikuar
- “KUPA” SHPK	119,948,000 lekë pa tvsh	skualifikuar
- “SHPRESA-AL” shpk	120,915,000 lekë pa tvsh	kualifikuar
- “KRONOS KONSTRUKSION” sh.p.k	144,295,000 lekë pa tvsh	skualifikuar
- “BAMI HOLDING” sh. p.k	148,128,000 lekë pa tvsh	kualifikuar
- “DAJTI PARK 2007 ” shpk	160,640,000 lekë pa tvsh	skualifikuar

II.4. Referuar sistemit të prokurimit elektronik rezulton, se më datë 27.06.2025, është publikuar në SPE njoftimi i fituesit paraprak.

II.5. Në datën 09.07.2025 nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2025/5541 dhe me nr.1836 prot., datë 10.07.2025 e BOE “Viante Konstruksion” SHPK dhe “Kegli-Duri” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr REF-36522-01-31-2025, me objekt: “Blerje Inerte”, me fond limit 161,080,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 05.03.2025, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugeve dhe Ndriçimit Publik Tirane.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 1836/ 1 prot., datë 10.07.2025.

II.7. Në datë 14.07.2025 BOE “Viante Konstruksion” SHPK dhe “Kegli-Duri” SHPK ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik nëpërmjet shërbimit postar ankesën për procedurën e mësipërme të prokurimit protokolluar me nr. 1836/2 prot., datë 14.07.2025.

II.8. Me shkresën me nr. 4441/1 prot., datë 16.07.2025, protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 1836/3 prot., datë 17.07.2025 Agjencia e Prokurimit Publik ka dërguar për kompetencë ankesën e dorëzuar nga BOE “Viante Konstruksion” SHPK dhe “Kegli-Duri” SHPK pranë Agjencisë së Prokurimit Publik për procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.9. Me shkresën me nr. 425/30 prot., datë 11.07.2025 me lëndë “Vënie në dijeni”, protokolluar me tonën me nr. 1863/4 prot., datë 17.07.2025 autoriteti kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Rugëve dhe Ndriçimit Publik ka vënë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për kërkesën drejtuar BOE “Viante Konstruksion” SHPK dhe “Kegli-Duri” SHPK për korrigjimin e të metave të ankesës me përmbajtje si vijon: *“...në zbatim të nenit 111 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar si dhe nenit 94 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” autoriteti konstatoi se ankimuesi duhet ti bashkëlidhë ankimit që ka paraqitur në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik, dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën pranë Komisionit të prokurimit Publik. Në datë 11.07.2025 nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor i kërkoj ankimuesit korrigjimin e ankesës brenda 2 (dy) ditëve nga njoftimi. Nëse ankesa nuk korrigjohet/plotësohet brenda këtij afati ajo konsiderohet si e paparaqitur.*

II.10. Me shkresën me nr. 425/32 prot., datë 14.07.2025 me lëndë “Vendim Komisioni i shqyrtimit të Ankesave”, protokolluar me tonën me nr. 1836/5 prot., datë 17.07.2025 autoriteti kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Rugëve dhe Ndriçimit Publik ka dorëzuar aktin e trajtimit të ankesës së BOE “Viante Konstruksion” SHPK dhe “Kegli-Duri” SHPK nga ku rezulton se e ka refuzuar atë.

II.11. Me shkresën me nr. 1836/6 prot., datë 22.08.2025 me lëndë “Njoftim për seancë dëgjimore pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni ka njoftuar BOE “Viante Konstruksion” SHPK dhe “Kegli-Duri” SHPK si vijon: *“Nga shqyrtimi i ankesës rezulton se, objekti i saj lidhet me vendimmarrjen e KVO-së mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga ana juaj. Gjithashtu pretendoni se nuk jeni njoftuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (SPE) lidhur me publikimin e Njoftimit të Fituesit Paraprak nga autoriteti kontraktor. Me qëllim gjykimin e ankesës së paraqitur, në zbatim të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” si dhe neneve 23, 24 dhe 26 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon të nevojshëm zhvillimin e një seance dëgjimore në ambientet e institucionit tonë me përfaqësues të BOE “Viante Konstruksion” SHPK dhe “Kegli-Duri” SHPK (ku njëri prej tyre të jetë një person i cili disponon të dhënat për tu futur në llogarinë e tij në Sistemin e Prokurimit Elektronik).Seanca dëgjimore do të zhvillohet ditën e martë, datë 26.08.2025 ora 12:00.”*

II.12. Me shkresën me datë 25.08.2025 me lëndë “Kërkesë për informacion”, protokolluar me tonën me nr. 1836/7 prot., datë 27.08.2025 drejtuar autoritetit kontraktor Drejtorisë së Përgjithshme të Rugëve dhe Ndriçimit Publik, Tiranë dhe për dijeni Komisionit të Prokurimit Publik, operatori ekonomik “Viante Konstruksion” SHPK ka vënë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik si vijon: *“[...] duke marrë shkas nga faktet dhe nga vlerësimi i autoritetit kontraktor dhe bindjes tonë, kemi ankimuar (brenda afateve ligjore) me datë 09.07.2025 dhe njëkohësisht kemi kryer pagesën konform procedurës ligjore. Ankmimi jonë është pranuar nga oragani kompetent dhe është publikuar menjëherë në sistemin online të pasqyrave të ankimimeve”.*

II.13. Me shkresën me nr. 1836/8 prot., datë 26.08.2025 me lëndë “Kërkesë për informacion”, drejtuar autoritetit kontraktor Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, Tiranë dhe për dijeni BOE “Viante Konstruksion” SHPK dhe “Kegli-Duri” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik ka kërkuar informacionin si vijon: *“Në kuadër të shqyrtimit të ankesës së BOE “Viante Konstruksion” SHPK dhe “Kegli-Duri” SHPK, mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së paraqitur nga BOE “Viante Konstruksion” SHPK dhe “Kegli-Duri” SHPK, në mbështetje të nenit 82 pika 5 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe nenit 26 të Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, kërkojmë nga institucioni juaj, të dorëzoni pranë KPP-së dokumentacionin e dorëzuar pranë autoritetit tuaj nga BOE “Viante Konstruksion” SHPK dhe “Kegli-Duri” SHPK, në përmbushje të pikës 6 të nenit 26 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Sa më sipër, me qëllim vijimin e gjyqimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, kërkojmë nga ana juaj të paraqisni pranë Komisionit të Prokurimit Publik, dokumentacionin e mësipërm, brenda ditës së nesërme nga marrja dijeni e kësaj shkrese”.*

II.14. Me shkresën me nr. 3999/1 prot., datë 29.08.2025 me lëndë “Kthim përgjigje”, protokolluar me tonën me nr. 1836/9 prot., datë 17.09.2025 autoriteti kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik Tiranë ka dorëzuar pranë KPP-së dokumentacionin e njehsuar me origjinalin të dorëzuar pranë autoritetit kontraktor nga BOE “Viante Konstruksion” SHPK dhe “Kegli-Duri” SHPK.

II.15. Me vendimin nr. Nr. 1317/2025, datë 24.09.2025 Komisioni i Prokurimit Publik vendosi:

1. *Të pranojë ankesën e BOE “Viante Konstruksion” SHPK dhe “Kegli-Duri” SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr REF-36522-01-31-2025, me objekt: “Blerje Inerte”, me fond limit 161,080,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 05.03.2025, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik Tiranë.*
2. *Autoriteti kontraktor të kryejë rivlerësimin e procedurës së prokurimit sipas konstatimeve të mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.*
3. *Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi, duke dokumentuar veprimet e kryera.*
4. *Ngarkohet zyra e financës, të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga BOE “Viante Konstruksion” SHPK dhe “Kegli-Duri” SHPK.*
5. *Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
6. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

II.16. Në datë 30.09.2025 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e rivlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

- OUEEN shpk	107,921,000 lekë pa tvsh	skualifikuar
--------------	--------------------------	--------------

- BOE “VIANTE Konstruksion” shpk & “KEGLI-DURI shpk” 107,979,600 lekë pa tvsh kualifikuar
- “KUPA” SHPK 119,948,000 lekë pa tvsh skualifikuar
- “SHPRESA-AL” shpk 120,915,000 lekë pa tvsh kualifikuar
- “KRONOS KONSTRUKSION” sh.p.k 144,295,000 lekë pa tvsh skualifikuar
- “BAMI HOLDING” sh. p.k 148,128,000 lekë pa tvsh kualifikuar
- “DAJTI PARK 2007 ” shpk 160,640,000 lekë pa tvsh skualifikuar

II.17. Me shkresën me nr. 3999/3 prot., datë 30.09.2025 me lëndë “Zbatim vendimi nr. 1317/2025, datë 24.09.2025”, protokolluar me tonën nr. 1836/14 prot., datë 02.10.2025 autoriteti kontraktor, njofton se ka zbatuar vendimin 1317/2025, datë 24.09.2025 të Komisionit të Prokurimit Publik për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr REF-36522-01-31-2025, me objekt: “Blerje Inerte”, me fond limit 161,080,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 05.03.2025, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik Tiranë”.

II.18 Me vendimin nr. Nr. 1380/2025, datë 03.10.2025 Komisioni i Prokurimit Publik vendosi:

1. *Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr REF-36522-01-31-2025, me objekt: “Blerje Inerte”, me fond limit 161,080,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 05.03.2025, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik Tiranë.*
2. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

II.19. Në datë 08.10.2025 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e rivlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

- OUEN shpk 107,921,000 lekë pa tvsh skualifikuar
- BOE “VIANTE Konstruksion” shpk & “KEGLI-DURI shpk” 107,979,600 lekë pa tvsh skualifikuar
- “KUPA” SHPK 119,948,000 lekë pa tvsh skualifikuar
- “SHPRESA-AL” shpk 120,915,000 lekë pa tvsh kualifikuar
- “KRONOS KONSTRUKSION” sh.p.k 144,295,000 lekë pa tvsh skualifikuar
- “BAMI HOLDING” sh. p.k 148,128,000 lekë pa tvsh kualifikuar
- “DAJTI PARK 2007 ” shpk 160,640,000 lekë pa tvsh skualifikuar

BOE “VIANTE Konstruksion” shpk & “KEGLI-DURI shpk rezulton i skualifikuar me arsyetimin se:

Rrethanat e Faktit: Më datë 30.09.2025 Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të vendimit Nr 1317/2025 Datë 24.09.2025 të Komisionit të Prokurimit Publik i cili ka vendosur si më poshtë : 1. Të pranojë ankesën e BOE “Viante Konstruksion” SHPK dhe “Kegli-Duri” SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr REF-36522-01- 31-2025, me objekt: “Blerje Inerte”, me fond limit 161,080,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 05.03.2025, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik. 2. Autoriteti kontraktor të kryejë rivlerësimin e procedurës së prokurimit sipas konstatimeve të mësipërme te Komisionit të Prokurimit Publik. 3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi, duke dokumentuar veprimet e kryera. 4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga BOE “Viante Konstruksion” SHPK dhe “Kegli-Duri” SHPK. 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit. 6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë. Vendosi të kualifikojë Ofertën e paraqitur nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “Viante Konstruksion” SHPK NUIS K47103804L dhe “Kegli Duri” SHPK NUIS K94016202U. Rrethanat e çështjes Në datë 30.09.2025 nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronike Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “Viante Konstruksion” SHPK NUIS K47103804L dhe “Kegli Duri” SHPK NUIS K94016202U njoftohen per dorëzimin e dokumentacionit në bazë të Nenit 26 Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” (LPP) (i ndryshuar) si dhe në zbatim të vendimit Nr 1317/2025 Datë 24.09.2025 të Komisionit të Prokurimit Publik. Në datën 02.10.2025 janë dorëzuar dokumentacioni nëpërmjet shkresës me Nr.Prot 3999/4 pranë Zyrës së Protokollit të Autoritetit Kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik Tiranë. Në vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik nr. 1317/2025 të cilin Autoriteti Kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik Tiranë është i detyruar ta zbatojë ka përcaktuar qartë se BOE duhet të zëvendësojë subjektin mbështetës në rast se ai është në kushtet e përjashtimit / skualifikimi konkretisht me arsyetimin si me poshtë vijon : Neni 84 pika 4. Autoriteti ose enti kontraktor duhet të sigurohet se për subjektin, aftësinë e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij. Autoriteti ose enti kontraktor duhet t’i kërkojë operatorit ekonomik që të zëvendësojë subjektin që ndodhet në kushtet e skualifikimit apo të përjashtimit.” Referuar pikës 4 të nenit 84 të LPP-së, përcaktohet, se autoriteti ose enti kontraktor duhet të sigurohet se për subjektin, aftësinë e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij dhe në ato raste kur vërteton se këto shkaqe ekzistojnë, autoriteti ose enti kontraktor duhet t’i kërkojë operatorit ekonomik që të zëvendësojë subjektin që ndodhet në kushtet e skualifikimit apo të përjashtimit. Në rastin konkret rezulton se, autoriteti kontraktor ka konstatuar mangësi fizike të dokumentacionit të dorëzuar për subjektin mbi kapacitetin e të cilit do të mbështetet BOE ankimues. Nga shqyrtimi i informacionit dhe dokumentacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor, për këtë procedurë prokurimi, nuk vërtetohet në asnjë moment që autoriteti kontraktor, në lidhje me arsyen e mësipërme të skualifikimit të ketë kryer veprimet procedurale të parashikuara në pikën 4 të nenit 84 të LPP-së, duke i kërkuar operatorit ekonomik që të zëvendësojë subjektin që ndodhet në kushtet e skualifikimit. Për këtë arsye, për sa kohë, nga ana e autoritetit kontraktor nuk janë respektuar të gjitha hapat procedurale, të parashikuara në ligj, skualifikimi i operatorit ekonomik ankimues, për arsyen e mësipërme nuk është i drejtë. Vlen të theksojmë se, autoriteti kontraktor, ka detyrimin që në zhvillimin e procedurave të prokurimit të zbatojë me përpikëri

të gjitha parashikimet ligjore, më qëllim mosdiskriminimin dhe trajtimin e barabartë të operatorëve ekonomikë..... Sipas nenit 84, pika 4 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), autoriteti ose enti kontraktor duhet të sigurohet që për subjektin mbështetës nuk ekzistojnë shkak për skualifikim ose përjashtim, dhe duhet t’i kërkojë operatorit ekonomik që të zëvendësojë subjektin mbështetës nëse ai është në kushtet e skualifikimit / përjashtimit. Sipas arsyetimit të KPP Autoriteti Kontraktor ka detyrim ligjor që të mos e skualifikojë menjëherë operatorin, por ti japë mundësi operatorit që ta zëvendësojë subjektin mbështetës me një tjetër që nuk ka arsye për skualifikim. Nga verifikimi i dokumentacioni të dorëzuar në Autoritet u konstatua se BOE nuk ka bërë zëvendësim të subjektit mbështetës duke paraqitur një subjekt tjetër mbështetës që të mos jetë i përjashtuar ose skualifikueshëm, por ka dorëzuar sërish dokumentacionin e të njëjtit subjekt mbështetës që ishte në kushtet e skualifikimit OE MURATI shpk duke bërë plotësimin e mangësive të konstatuara me herët nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave. Pra BOE nuk ka përmbushur detyrimin për të kualifikuar veten në mënyrë të vlefshme, sipas kërkesave të procedurës dhe ka vazhduar të mbështetet te një subjekt që ishte në kushtet e skualifikimit, çka është në kundërshtim me nenin 84/4 të LPP dhe vendimin Nr. 1317/2025 të KPP. Nga ana e Autoritetit Kontraktor janë marrë të gjitha veprimet në përputhje me vendimin e KPP(nr. 1317/2025) dhe nenin 84 pika 4 të LPP dhe BOE është njoftuar që të zëvendësojë subjektin mbështetës që nuk plotëson kushtet ligjore. Duke mos e bërë këtë zëvendësim, BOE nuk i është përgjigjur në mënyrë të saktë këtij vendimi, duke mohuar mundësinë e rishikimit të dokumentacionit dhe qartësimit të plotë të kapacitetit të tij. Edhe pse autoriteti kontraktor i ka dhënë BOE mundësinë për të zëvendësuar subjektin mbështetës në përputhje me nenin 84/4 të LPP dhe vendimin e KPP, BOE ka zgjedhur të dorëzojë përsëri dokumentacionin e të njëjtit subjekt mbështetës, për të cilin është konstatuar se ndodhet në kushtet e skualifikimit/përjashtimit. Ky veprim nuk përbën zëvendësim dhe rrjedhimisht nuk përmbush kërkesat e ligjit. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nisur nga arsyetimi sa më lart vendos: Duke qënë se BOE ka përdorur subjektin që sipas analizës së një vendimi të mëparshëm të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ishte në kushtet e skualifikimit, oferta e BOE përbëhet nga një element i papajtueshëm me kërkesat ligjore duke e bërë ofertën jo të vlefshme për pjesën ku bazohet në këtë subjekt. Autoriteti kontraktor është i detyruar të zbatojë vendimin nr. 1317/2025 të KPP, si organ i krijuar me fuqi ligjore për të kontrolluar proceset e prokurimit dhe vendimet e marra nga Komisioni janë administrativisht përfundimtare mbështetur nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar Vendimet e Komisionit të Prokurimit Publik janë detyruese për autoritetin kontraktor, dhe zbatimi i tyre nuk është fakultativ, por obligim ligjor. Në mungesë të zëvendësimit të subjektit mbështetës, në përputhje me kërkesat e ligjit dhe vendimit të KPP, autoriteti kontraktor ka detyrimin të përjashtojë BOE nga procedura e prokurimit, për shkak të mosplotësimit të kriterëve të kualifikimit dhe moszbatimit të vendimit të KPP-së.

II.20. Në datë 09.10.2025 autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE Njoftimin e Fituesit Paraprak për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.21. Në datën 19.10.2025 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 2912/2025 protokolli dhe me numër ankimi elektronik A/2025/5959 e BOE “Viante Konstruksion” SHPK dhe “Kegli-Duri” SHPK

për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr REF-36522-01-31-2025, me objekt: “Blerje Inerte”, me fond limit 161,080,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 05.03.2025, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik Tiranë.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga BOE “Viante Konstruksion” SHPK dhe “Kegli-Duri” SHPK.

II.22. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 2912/ 1 prot., datë 20.10.2025.

II.23. Me shkresën me nr. 3999/10 prot., datë 24.10.2025, protokolluar me tonën me nr. 2912/2 prot., datë 27.10.2025 autoriteti kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik Tiranë ka dorëzuar nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike vendimin e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave për ankesën e BOE ankimues “Viante Konstruksion” SHPK dhe “Kegli-Duri” SHPK nga ku rezulton se e ka refuzuar atë.

II.24. Me shkresën me nr. 3999/11 prot., datë 24.10.2025, protokolluar me tonën me nr. 2912/3 prot., datë 27.10.2025 autoriteti kontraktor ka dorëzuar nëpërmjet shërbimit postar vendimin e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave për ankesën e BOE ankimues Viante Konstruksion” SHPK dhe “Kegli-Duri” SHPK.

II.25. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se nuk janë dorëzuar argumente nga subjekte të interesuara në përputhje me nenin 113 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e bashkimit të operatorit ekonomik ankimues për kundërshtimin e skualifikimit të tij me arsyetimin se: *“[...] Ne rastin konkret kembengulim me plote bindje qe jo vetem neni 84 pika 4 eshte shkelur katerciperisht nga ky institucion por dhe vendimarrja e Komisionit Prokurimit Publik, e themi kete pasi ne menyre mjaft te qarte dhe shqip ne vendimin*

e saj KPP-se ashtu sikurse e dikton dhe ligji pra neni 84 pika 4, i eshte lene detyre AK qe te na kerkoje ZEVENDESIMIN E SUBJEKTIT MBESHTETES, por c'ndodh, sipas njoftimit te dates 30.09.2025 "Date 30.09.2025 në zbatim të nenit 26, pika 6 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndricimit Publik, me adresë rruga 5 Maj, Tiranë njofton BOE "VIANTE Konstruktion" shpk & "KEGLI-DURI shpk" të dorëzojë pranë Zyrës së Protokollit, Brenda 3 ditëve dokumentat provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "I", "j", të pikës 2 të nenit të sipërpërmendur si dhe dokumentet e tjera shoqeruese sipas vendimit të me nr. 1317/2025, datë 24.09.2025 të Komisionit Prokurimit Publik për procedurën e prokurimit me objekt "Blerje Inerte", me Nr. Ref-36522-01-31. Këto dokumenta duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehësuar me origjinalin si dhe të inventarizuara". Sipas ketij njoftimi nuk rezulton qe ne asnje fjale dhe asnje rrjesht te tij, qe autoriteti ne zbatim te nenit 84 pika 4 dhe vendimit te KPP-se te na kete kerkuar ZEVENDESIMIN E SUBJEKTIT MBESHTETES, qellimin e djallezure te ketij institucioni nuk kemi arritur ta kuptojme edhe sot e kesaj dite. Referuar arsyes se skualifikimit te cilen autoriteti kontraktor na ka komunikuar nepermjete SPE rezulton se si arsye skualifikimi ka vendosur te gjithe pjesen arsyetuese te vendimit te Komisionit Prokurimit Publik, pra rezulton se e ka kuptuar mese miri vendimine KPP-se [...]”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në datën 03-02-2025, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit "E hapur, mbi kufirin e lartë monetar", me Nr REF-36522-01-31-2025, me objekt: "Blerje Inerte", me fond limit 161,080,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 05.03.2025, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik Tiranë.

III.1.2. Në datën 05-03-2025, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

III.1.3. Në datën 24.06.2025, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

- OUEEN shpk	107,921,000 lekë pa tvsh	skualifikuar
- BOE "VIANTE Konstruktion" shpk & "KEGLI-DURI shpk"	107,979,600 lekë pa tvsh	skualifikuar
- "KUPA" SHPK	119,948,000 lekë pa tvsh	skualifikuar
- "SHPRESA-AL" shpk	120,915,000 lekë pa tvsh	kualifikuar
- "KRONOS KONSTRUKSION" sh.p.k	144,295,000 lekë pa tvsh	skualifikuar
- "BAMI HOLDING" sh. p.k	148,128,000 lekë pa tvsh	kualifikuar
- "DAJTI PARK 2007 " shpk	160,640,000 lekë pa tvsh	skualifikuar

III.1.4. Referuar sistemit të prokurimit elektronik rezulton, se më datë 27.06.2025, është publikuar në SPE njoftimi i fituesit paraprak.

III.1.5. Në datën 09.07.2025 nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2025/5541 dhe me nr.1836 prot., datë 10.07.2025 e BOE “Viante Konstruksion” SHPK dhe “Kegli-Duri” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr REF-36522-01-31-2025, me objekt: “Blerje Inerte”, me fond limit 161,080,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 05.03.2025, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik Tiranë.

III.1.6. Me vendimin nr. Nr. 1317/2025, datë 24.09.2025 Komisioni i Prokurimit Publik vendosi:

1. *Të pranojë ankesën e BOE “Viante Konstruksion” SHPK dhe “Kegli-Duri” SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr REF-36522-01-31-2025, me objekt: “Blerje Inerte”, me fond limit 161,080,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 05.03.2025, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik Tirane.*
2. *Autoriteti kontraktor të kryejë rivlerësimin e procedurës së prokurimit sipas konstatimeve të mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.*
7. *Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi, duke dokumentuar veprimet e kryera.*
8. *Ngarkohet zyra e financës, të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga BOE “Viante Konstruksion” SHPK dhe “Kegli-Duri” SHPK.*
9. *Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
10. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

III.1.7 Në datë 30.09.2025 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e rivlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

- OUEEN shpk	107,921,000 lekë pa tvsh	skualifikuar
- BOE “VIANTE Konstruksion” shpk & “KEGLI-DURI shpk”	107,979,600 lekë pa tvsh	kualifikuar
- “KUPA” SHPK	119,948,000 lekë pa tvsh	skualifikuar
- “SHPRESA-AL” shpk	120,915,000 lekë pa tvsh	kualifikuar
- “KRONOS KONSTRUKSION” sh.p.k	144,295,000 lekë pa tvsh	skualifikuar
- “BAMI HOLDING” sh. p.k	148,128,000 lekë pa tvsh	kualifikuar
- “DAJTI PARK 2007 ” shpk	160,640,000 lekë pa tvsh	skualifikuar

III.1.8 Me shkresën me nr. 3999/3 prot., datë 30.09.2025 me lëndë “Zbatim vendimi nr. 1317/2025, datë 24.09.2025”, protokolluar me tonën nr. 1836/14 prot., datë 02.10.2025 autoriteti kontraktor, njofton se ka zbatuar vendimin 1317/2025, datë 24.09.2025 të Komisionit të Prokurimit Publik për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr REF-36522-01-31-2025, me objekt: “Blerje Inerte”, me fond limit 161,080,000.00 lekë pa

TVSH, zhvilluar në datën 05.03.2025, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik Tiranë”.

III.1.9 Me vendimin nr. Nr. 1380/2025, datë 03.10.2025 Komisioni i Prokurimit Publik vendosi:

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr REF-36522-01-31-2025, me objekt: “Blerje Inerte”, me fond limit 161,080,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 05.03.2025, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik Tiranë.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

III.1.10. Në datë 08.10.2025 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e rivlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

- OUEEN shpk	107,921,000 lekë pa tvsh	skualifikuar
- BOE “VIANTE Konstruksion” shpk & “KEGLI-DURI shpk”	107,979,600 lekë pa tvsh	skualifikuar
- “KUPA” SHPK	119,948,000 lekë pa tvsh	skualifikuar
- “SHPRESA-AL” shpk	120,915,000 lekë pa tvsh	kualifikuar
- “KRONOS KONSTRUKSION” sh.p.k	144,295,000 lekë pa tvsh	skualifikuar
- “BAMI HOLDING” sh. p.k	148,128,000 lekë pa tvsh	kualifikuar
- “DAJTI PARK 2007 ” shpk	160,640,000 lekë pa tvsh	skualifikuar

BOE “VIANTE Konstruksion” shpk & “KEGLI-DURI shpk rezulton i skualifikuar me arsytimin se:

Rrethanat e Faktit: Më datë 30.09.2025 Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të vendimit Nr 1317/2025 Datë 24.09.2025 të Komisionit të Prokurimit Publik i cili ka vendosur si më poshtë : 1. Të pranojë ankesën e BOE “Viante Konstruksion” SHPK dhe “Kegli-Duri” SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr REF-36522-01- 31-2025, me objekt: “Blerje Inerte”, me fond limit 161,080,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 05.03.2025, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik. 2. Autoriteti kontraktor të kryejë rivlerësimin e procedurës së prokurimit sipas konstatimeve të mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik. 3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi, duke dokumentuar veprimet e kryera. 4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga BOE “Viante Konstruksion” SHPK dhe “Kegli-Duri” SHPK. 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit. 6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë. Vendosi të kualifikojë Ofertën e paraqitur nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë

“Viante Konstruktion” SHPK NUIS K47103804L dhe “Kegli Duri” SHPK NUIS K94016202U. Rrethanat e çështjes Në datë 30.09.2025 nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronike Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “Viante Konstruktion” SHPK NUIS K47103804L dhe “Kegli Duri” SHPK NUIS K94016202U njoftohen për dorëzimin e dokumentacionit në bazë të Nenit 26 Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” (LPP) (i ndryshuar) si dhe në zbatim të vendimit Nr 1317/2025 Datë 24.09.2025 të Komisionit të Prokurimit Publik. Në datën 02.10.2025 janë dorëzuar dokumentacioni nëpërmjet shkresës me Nr.Prot 3999/4 pranë Zyrës së Protokollit të Autoritetit Kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik Tiranë. Në vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik nr. 1317/2025 të cilin Autoriteti Kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik Tiranë është i detyruar ta zbatojë ka përcaktuar qartë se BOE duhet të zëvendësojë subjektin mbështetës në rast se ai është në kushtet e përjashtimit / skualifikimi konkretisht me arsyetimin si me poshtë vijon : Neni 84 pika 4. Autoriteti ose enti kontraktor duhet të sigurohet se për subjektin, aftësinë e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij. Autoriteti ose enti kontraktor duhet t’i kërkojë operatorit ekonomik që të zëvendësojë subjektin që ndodhet në kushtet e skualifikimit apo të përjashtimit.” Referuar pikës 4 të nenit 84 të LPP-së, përcaktohet, se autoriteti ose enti kontraktor duhet të sigurohet se për subjektin, aftësinë e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij dhe në ato raste kur vërtetohet se këto shkaqe ekzistojnë, autoriteti ose enti kontraktor duhet t’i kërkojë operatorit ekonomik që të zëvendësojë subjektin që ndodhet në kushtet e skualifikimit apo të përjashtimit. Në rastin konkret rezultoi se, autoriteti kontraktor ka konstatuar mangësi fizike të dokumentacionit të dorëzuar për subjektin mbi kapacitetin e të cilit do të mbështetet BOE ankimues. Nga shqyrtimi i informacionit dhe dokumentacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor, për këtë procedurë prokurimi, nuk vërtetohet në asnjë moment që autoriteti kontraktor, në lidhje me arsyen e mësipërme të skualifikimit të ketë kryer veprimet procedurale të parashikuara në pikën 4 të nenit 84 të LPP-së, duke i kërkuar operatorit ekonomik që të zëvendësojë subjektin që ndodhet në kushtet e skualifikimit. Për këtë arsye, për sa kohë, nga ana e autoritetit kontraktor nuk janë respektuar të gjitha hapat procedurale, të parashikuara në ligj, skualifikimi i operatorit ekonomik ankimues, për arsyen e mësipërme nuk është i drejtë. Vlen të theksojmë se, autoriteti kontraktor, ka detyrimin që në zhvillimin e procedurave të prokurimit të zbatojë me përpikëri të gjitha parashikimet ligjore, më qëllim mosdiskriminimin dhe trajtimin e barabartë të operatorëve ekonomikë..... Sipas nenit 84, pika 4 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), autoriteti ose enti kontraktor duhet të sigurohet që për subjektin mbështetës nuk ekzistojnë shkak për skualifikim ose përjashtim, dhe duhet t’i kërkojë operatorit ekonomik që të zëvendësojë subjektin mbështetës nëse ai është në kushtet e skualifikimit / përjashtimit. Sipas arsyetimit të KPP Autoriteti Kontraktor ka detyrim ligjor që të mos e skualifikojë menjëherë operatorin, por ti japë mundësi operatorit që ta zëvendësojë subjektin mbështetës me një tjetër që nuk ka arsye për skualifikim. Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në Autoritet u konstatua se BOE nuk ka bërë zëvendësim të subjektit mbështetës duke paraqitur një subjekt tjetër mbështetës që të mos jetë i përjashtuar ose skualifikueshëm, por ka dorëzuar sërish dokumentacionin e të njëjtit subjekt mbështetës që është në kushtet e skualifikimit OE MURATI shpk duke bërë plotësimin e mangësive të konstatuara me herët nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave. Pra BOE nuk ka përmbushur detyrimin për të kualifikuar veten në mënyrë të vlefshme, sipas kërkesave të

procedurës dhe ka vazhduar të mbështetet te një subjekt që ishte në kushtet e skualifikimit, çka është në kundërshtim me nenin 84/4 të LPP dhe vendimin Nr. 1317/2025 të KPP. Nga ana e Autoritetit Kontraktor janë marrë të gjitha veprimet në përputhje me vendimin e KPP(nr. 1317/2025) dhe nenin 84 pika 4 të LPP dhe BOE është njoftuar që të zëvendësojë subjektin mbështetës që nuk plotëson kushtet ligjore. Duke mos e bërë këtë zëvendësim, BOE nuk i është përgjigjur në mënyrë të saktë këtij vendimi, duke mohuar mundësinë e rishikimit të dokumentacionit dhe qartësimin të plotë të kapacitetit të tij. Edhe pse autoriteti kontraktor i ka dhënë BOE mundësinë për të zëvendësuar subjektin mbështetës në përputhje me nenin 84/4 të LPP dhe vendimin e KPP, BOE ka zgjedhur të dorëzojë përsëri dokumentacionin e të njëjtit subjekt mbështetës, për të cilin është konstatuar se ndodhet në kushtet e skualifikimit/përrjashtimit. Ky veprim nuk përbën zëvendësim dhe rrjedhimisht nuk përmbush kërkesat e ligjit. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nisur nga arsyetimi sa më lart vendos: Duke qënë se BOE ka përdorur subjektin që sipas analizës së një vendimi të mëparshëm të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave është në kushtet e skualifikimit, oferta e BOE përbëhet nga një element i papajtueshëm me kërkesat ligjore duke e bërë ofertën jo të vlefshme për pjesën ku bazohet në këtë subjekt. Autoriteti kontraktor është i detyruar të zbatojë vendimin nr. 1317/2025 të KPP, si organ i krijuar me fuqi ligjore për të kontrolluar proceset e prokurimit dhe vendimet e marra nga Komisioni janë administrativisht përfundimtare mbështetur nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar Vendimet e Komisionit të Prokurimit Publik janë detyruese për autoritetin kontraktor, dhe zbatimi i tyre nuk është fakultativ, por obligim ligjor. Në mungesë të zëvendësimit të subjektit mbështetës, në përputhje me kërkesat e ligjit dhe vendimit të KPP, autoriteti kontraktor ka detyrimin të përjashtojë BOE nga procedura e prokurimit, për shkak të mosplotësimit të kriterëve të kualifikimit dhe moszbatimit të vendimit të KPP-së.

III.1.11. Në datë 09.10.2025 autoriti kontraktor ka publikuar në SPE Njoftimin e Fituesit Paraparak për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

III.1.12. Në datën 19.10.2025 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 2912/2025 protokolli dhe me numër ankimi elektronik A/2025/5959 e BOE “Viante Konstruksion” SHPK dhe “Kegli-Duri” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr REF-36522-01-31-2025, me objekt: “Blerje Inerte”, me fond limit 161,080,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 05.03.2025, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Rugëve dhe Ndriçimit Publik Tiranë. Nga shqyrtimi paraparak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga BOE “Viante Konstruksion” SHPK dhe “Kegli-Duri” SHPK.

III.1.13. Me shkresën me nr. 3999/10 prot., datë 24.10.2025, protokolluar me tonën me nr. 2912/2 prot., datë 27.10.2025 autoriteti kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Rugëve dhe Ndriçimit Publik Tiranë ka dorëzuar nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike vendimin e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave për ankesën e BOE ankimues “Viante Konstruksion” SHPK dhe “Kegli-Duri” SHPK nga ku rezulton se e ka refuzuar atë.

III.1.14. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr.162/2022 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se: *“Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

III.1.15. Neni 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr.162/2022 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se: *“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”*

III.1.16. Në nenin 84 “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar përcaktohet se: *“1. Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta. 2. Operatori ekonomik mund ta shfrytëzojë aftësinë e ndonjë subjekti tjetër për të dëshmuar plotësimin e kushteve në lidhje me kualifikimet arsimore dhe profesionale vetëm nëse subjekti tjetër i kryen punët ose do t'i sigurojë shërbimet për të cilat kërkohet aftësi e tillë. 3. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim. 4. Autoriteti ose enti kontraktor duhet të sigurohet se për subjektin, aftësinë e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij. Autoriteti ose enti kontraktor duhet t'i kërkojë operatorit ekonomik që të zëvendësojë subjektin që ndodhet në kushtet e skualifikimit apo të përjashtimit. 5. Nëse operatori ekonomik shfrytëzon aftësi nga subjekti tjetër në lidhje me kushtet që kanë të bëjnë me gjendjen ekonomike dhe financiare, autoriteti ose enti kontraktor mund të kërkojë që operatori ekonomik dhe subjekti të ndërmarrin përgjegjësi solidare për zbatimin e marrëveshjes. 6. Ndërkohë, në rastin kur operatorët ekonomikë mbështeten në kapacitetet e subjekteve të tjera, pasi këta të fundit do të kryejnë furnizimet, punët ose shërbimet, për të cilat kërkohen këto kapacitete, atëherë grupi i operatorëve ekonomikë mund të dorëzojë oferta ose të paraqitet si një kandidat i vetëm. 7. Në rastin e kontratave të punëve, shërbimeve dhe vendosjes ose instalimit në kuadër të një kontrate furnizimi, autoriteti ose enti kontraktor mund të kërkojë që detyra/punë/aspekte kritike të kontratës të përmbushen nga vetë operatori ekonomik ose nga ndonjëri prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ofertues.”*

III.1.17. Në nenin 26 pika 2 dhe 6 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se:

“2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarimin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohej për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi;

l) operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;

ll) operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.

6. Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Në procedurat e prokurimit me faza, ky dokumentacion i

kërkohet të gjithë kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit.

Ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë dokumentet provuese, të cilat duhet të jenë në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin. Për dokumentet e ofertës, të ngarkuara në sistemin e prokurimit elektronik, ofertuesi i kualifikuar i pari duhet t'i paraqesë këto dokumenta në origjinal ose të njehsuara me origjinalin. Gjithashtu, dokumentet provuese, që do të paraqiten për të provuar vetëdeklarimet e bëra, duhet të paraqiten në origjinal ose të njehsuara me origjinalin dhe të provojnë gjendjen faktike të ofertuesit në kohën e ofertimit të tij. Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike. Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj. Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.”

III.1.18. Në nenin 90 “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “1. Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta, sipas përcaktimit në nenin 84, të LPP-së. 2. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai duhet:

- ta deklarojë një gjë të tillë që në dokumentet e ofertës;
- t'i vërtetojë me dokumentacion provues autoritetit/entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme.
- t'i provojë autoritetit/entit kontraktor se për subjektin, aftësinë, e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij nga procedura, sipas parashikimeve të nenit 76, të LPP-së.
- Në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor.

3. Kur operatori ekonomik kërkon të mbështetet në aftësinë e ndonjë subjekti tjetër për të dëshmuar plotësimin e kushteve në lidhje me kualifikimet arsimore dhe profesionale, atëherë shërbimet, për të cilat kërkohet një aftësi e tillë ose punët do të kryhen nga subjekti tjetër.

4. Kur operatori ekonomik kërkon të mbështetet në aftësinë e një subjekti tjetër në lidhje me kushtet që kanë të bëjnë me gjendjen ekonomike dhe financiare, autoriteti ose enti kontraktor mund të kërkojë që operatori ekonomik dhe subjekti të ndërmarrin përgjegjësi solidare për zbatimin e kontratës.

5. Kur operatori ekonomik kërkon të mbështetet në aftësinë e subjekteve të tjera, pasi këta të fundit do të kryejnë furnizimet, punët ose shërbimet, për të cilat kërkohen këto kapacitete, atëherë grupi i operatorëve ekonomikë mund të dorëzojnë oferta ose të paraqiten si një kandidat i vetëm.

6. Në rastin e kontratave të punëve, shërbimeve dhe vendosjes ose instalimit në kuadër të një kontrate furnizimi, autoriteti/enti kontraktor, mund të kërkojë që për kryerjen e detyrave/punëve/aspekteve kritike të kontratës të mos mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera por të përmbushen nga vetë ofertuesi. Ky informacion publikohet në dokumentet e tenderit.

7. Subjekti mbështetës nuk mund të jetë njëkohësisht edhe ofertues në procedurën e prokurimit. Subjekti mbështetës nuk mund të mbështesë më shumë se një operator ekonomik në të njëjtën procedurë prokurimi.

III.1.19. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, nëpërmjet kriterëve për kualifikim, synohet sigurimi i ofertimit nga operatorë ekonomikë të përgjegjshëm, të cilët janë krijuar dhe veprojnë sipas legjislacionit shqiptar në fuqi apo legjislacionit të shtetit të origjinës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara në dokumentet e tenderit janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa. Komisioni gjykon se, referuar nenit 84 “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar përcaktohen kapacitetet mbi të cilat mund të mbështetesh tek një operatorë ekonomik konkretisht parashikohet se: “1. Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta. 2. Operatori ekonomik mund ta shfrytëzojë aftësinë e ndonjë subjekti tjetër për të dëshmuar plotësimin e kushteve në lidhje me kualifikimet arsimore dhe profesionale vetëm nëse subjekti tjetër i kryen punët ose do t'i sigurojë shërbimet për të cilat kërkohet aftësi e tillë. 3. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim. 4. Autoriteti ose enti kontraktor duhet të sigurohet se për subjektin, aftësinë e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij. Autoriteti ose enti kontraktor duhet t'i kërkojë operatorit ekonomik që të zëvendësojë subjektin që ndodhet në kushtet e skualifikimit apo të përjashtimit”. Ndërsa në nenin 90 “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se “1. Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta, sipas përcaktimit në nenin 84, të LPP-së. 2. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai duhet: - ta deklarojë një gjë të tillë që në dokumentet e ofertës; - t'i vërtetojë me dokumentacion provues autoritetit/entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme; - t'i provojë autoritetit/entit kontraktor se për subjektin, aftësinë, e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për

skualifikimin ose përjashtimin e tij nga procedura, sipas parashikimeve të nenit 76, të LPP-së;

- Në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor. Në Nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1, 2, 3, 6 dhe 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se, për pikën 1 të nenit 76 të Ligjit “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nga ana e operatorit ekonomik duhet të plotësohet formulari përmbledhës i vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në rregullat e prokurimit publik. Referuar dokumenteve të tenderit, në shtojcën 9 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, në pjesën e fundit përcaktohet, se, “në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës”, si dhe “Ndërsa, dokumentet provuese, që do të paraqiten për të provuar vetëdeklarimet e bëra, duhet të paraqiten në origjinal ose të njësuara me origjinalin dhe të provojnë gjendjen faktike të ofertuesit në kohën e ofertimit të tij”.

III.1.20. Referuar materialeve të ndodhura në fashikullin administrativ Komisioni konstaton, se për procedurën e prokurimit objekt ankimi, në datë 24.09.2025, pas shqyrtimit të ankesës me nr. 1836 prot., datë 10.07.2025, KPP është shprehur me vendimin nr. 1317/2025 ku në pjesën arsyetuese të këtij vendimi në pikën III.2.10 ka arsyetuar citoj: **“KPP, nisur nga arsyeja e skualifikimit të bashkimit të operatorëve ekonomik ankimues, si dhe nga administrimi i dokumentacionit të ndodhur në fashikullin administrativ gjykon se, në pikën 1 dhe 4 të nenit 84 “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar përcaktohet se: “1. Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta. 4. Autoriteti ose enti kontraktor duhet të sigurohet se për subjektin, aftësinë e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij. Autoriteti ose enti kontraktor duhet t’i kërkojë operatorit ekonomik që të zëvendësojë subjektin që ndodhet në kushtet e skualifikimit apo të përjashtimit.”** Referuar pikës 4 të nenit 84 të LPP-së, përcaktohet, se autoriteti ose enti kontraktor duhet të sigurohet se për subjektin, aftësinë e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij dhe në ato raste kur vërtetohet se këto shkaqe ekzistojnë, autoriteti ose enti kontraktor duhet t’i kërkojë operatorit ekonomik që të zëvendësojë subjektin që ndodhet në kushtet e skualifikimit apo të përjashtimit. Në rastin konkret rezulton se, autoriteti kontraktor ka konstatuar mangësi fizike të dokumentacionit të dorëzuar për subjektin mbi kapacitetin e të cilit do të mbështetet BOE ankimues. **Nga shqyrtimi i informacionit dhe dokumentacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor, për këtë procedurë prokurimi, nuk vërtetohet në asnjë moment që autoriteti kontraktor, në lidhje me arsyen e mësipërme të skualifikimit të ketë kryer veprimet procedurale të parashikuara në pikën 4 të nenit 84 të LPP-së, duke i kërkuar operatorit ekonomik që të zëvendësojë subjektin që ndodhet në kushtet e skualifikimit.** Për këtë arsye, për sa kohë, nga ana e autoritetit kontraktor nuk janë respektuar të gjitha hapat procedurale, të parashikuara në ligj, skualifikimi i operatorit ekonomik ankimues, për arsyen e mësipërme nuk është i drejtë. Vlen të theksojmë se, autoriteti kontraktor, ka detyrimin që në zhvillimin e

procedurave të prokurimit të zbatojë me përpikëri të gjitha parashikimet ligjore, më qëllim mosdiskriminimin dhe trajtimin e barabartë të operatorëve ekonomikë.”. Në datë 30.09.2025 autoriteti kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik Tiranë, ka kryer rivlerësimin e procedurës së prokurimit në SPE duke e kualifikuar BOE ankimues në zbatim të vendimit nr. 1317/2025, datë 24.09.2025 të KPP-së. Në datë 30.09.2025 nga verifikimi në SPE, në rubrikën “Kërkesa”, rezulton se autoriteti kontraktor i ka dërguar operatorit ekonomik “Viante Konstruksion” SHPK, anëtar i BOE ankimues, një kërkesë për dorëzim dokumentacioni me përmbajtje si vijon: “Datë 30.09.2025 Date 30.09.2025 në zbatim të nenit 26, pika 6 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndricimit Publik, me adresë rruga 5 Maj, Tiranë njofton BOE “VIANTE Konstruksion” shpk & “KEGLI-DURI shpk” të dorëzojë pranë Zyrës së Protokollit, Brenda 3 ditëve dokumentat provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “I”, “j”, të pikës 2 të nenit të sipërpërmendur si dhe dokumentet e tjera shoqeruese sipas vendimit të me nr. 1317/2025, datë 24.09.2025 të Komisionit Prokurimit Publik për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje Inerte”, me Nr. Ref-36522-01-31. Këto dokumenta duhet të paraqiten në original ose në kopje të njehësuar me origjinalin si dhe të inventarizuara”. Në datë 08.10.2025 autoriteti kontraktor ka kryer sërish rivlerësim duke e skualifikuar BOE “VIANTE Konstruksion” shpk & “KEGLI-DURI shpk nga procedura e prokurimit objekt ankimi me arsyetimin se: “[.] Nga verifikimi i dokumentacioni të dorëzuar në Autoritet u konstatua se BOE nuk ka bërë zëvendësim të subjektit mbështetës duke paraqitur një subjekt tjetër mbështetës që të mos jetë i përjashtuar ose skualifikueshëm, por ka dorëzuar sërish dokumentacionin e të njëjtit subjekt mbështetës që është në kushtet e skualifikimit OE MURATI shpk duke bërë plotësimin e mangësive të konstatuara me herët nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave [.]”. Në datë 09.10.2025 autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE njoftimin e fituesit paraprak për procedurën e prokurimit. Në datë 19.10.2025 BOE “Viante Konstruksion” SHPK dhe “Kegli-Duri” SHPK nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike ka dorëzuar ankesën protokolluar me nr. 2912/2025, me anë të së cilës kundërshton skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit objekt ankimi.

III.1.21. Nisur nga arsyeja e skualifikimit, referuar pretendimit të bashkimit të operatorëve ekonomik ankimues për kundërshtimin e skualifikimit të tij me arsyetimin se “...pas njoftimit të datës 30.09.2025 “Date 30.09.2025 në zbatim të nenit 26, pika 6 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndricimit Publik, me adresë rruga 5 Maj, Tiranë njofton BOE “VIANTE Konstruksion” shpk & “KEGLI-DURI shpk” të dorëzojë pranë Zyrës së Protokollit, Brenda 3 ditëve dokumentat provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “I”, “j”, të pikës 2 të nenit të sipërpërmendur si dhe dokumentet e tjera shoqeruese sipas vendimit të me nr. 1317/2025, datë 24.09.2025 të Komisionit Prokurimit Publik për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje Inerte”, me Nr. Ref-36522-01-31. Këto dokumenta duhet të paraqiten në original ose në kopje të njehësuar me origjinalin si dhe të inventarizuara”. Sipas këtij njoftimi nuk rezulton që ne asnjë fjale dhe asnjë rrjesht të tij, që autoriteti në zbatim të nenit 84 pika 4 dhe vendimit të KPP-së të na kete kerkuar ZEVENDESIMIN E SUBJEKTIT MBESHTETES”, si dhe nga verifikimi në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE), nga verifikimi në rubrikën “Kërkesa”, Komisioni konstaton se në datë 30.09.2025 ora 13:56

autoriteti kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Ndriçimit Publik, Tiranë, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike (SPE) i ka dërguar operatorit ekonomik Viante Konstruksion SHPK “Kërkesën për dorëzim dokumentacioni”, me përmbajtje si vijon: “*Datë 30.09.2025 Date 30.09.2025 në zbatim të nenit 26, pika 6 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndricimit Publik, me adresë rruga 5 Maj, Tiranë njofton BOE “VIANTE Konstruksion” shpk & “KEGLI-DURI shpk” të dorëzojë pranë Zyrës së Protokollit, **Brenda 3 ditëve dokumentat provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “I”, “j”, të pikës 2 të nenit të sipërpërmendur si dhe dokumentet e tjera shoqeruese sipas vendimit të me nr. 1317/2025, datë 24.09.2025 të Komisionit Prokurimit Publik për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje Inerte”, me Nr. Ref-36522-01-31. Këto dokumenta duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njëhësuar me origjinalin si dhe të inventarizuara***”. Referuar kërkesës së sipërpërmendur dërguar në SPE operatorit ekonomik “Viante Konstruksion” SHPK, Komisioni konstaton, se në kërkesën e dërguar autoriteti kontraktor ndër të tjera referon edhe vendimin nr. 1317/2025, datë 24.09.2025 të Komisionit të Prokurimit Publik, duke cituar qartësisht se BOE ankimues duhet të dorëzojë krahas dokumenteve të përcaktuara në nenin 26 pika 2 e VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 edhe dokumentat e tjera shoqëruese sipas vendimit me nr. 1317/2025, datë 24.09.2025 të Komisionit Prokurimit Publik. Lidhur me kërkesën e autoritetit kontraktor dhe konkretisht referuar vendimit të KPP-së nr. 1317/2025, datë 24.09.2025 në të cilën autoriteti kontraktor citon, Komisioni thekson, se autoriteti kontraktor me të vërtetë nuk ka cituar shprehimisht me togfjalëshin “zëvendësimin e mbështetësit”, por ka cituar vendimin e KPP-së, vendim me të cilin Komisioni është shprehur në pjesën arsyetuese të tij se autoriteti kontraktor duhet të sigurohet se për subjektin, aftësinë e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij dhe në ato raste kur vërtetohet se këto shkaqe ekzistojnë, autoriteti ose enti kontraktor duhet t’i kërkojë operatorit ekonomik që të zëvendësojë subjektin që ndodhet në kushtet e skualifikimit apo të përjashtimit.. Në kushtet kur autoriteti kontraktor ka cituar vendimin nr. 1317/2025, datë 24.09.2025, si dhe BOE ankimues ishte në dijeni se referuar nenit 84, pika 4 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar si dhe vendimit nr. 1317/2025, datë 24.09.2025 të KPP-së autoriteti duhet të kërkojë zëvendësimin e mbështetësit mbi kapacitete, në momentin që ka BOE ankimues ka marrë njoftimin në SPE dhe ishte njohur me vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik, ka marrë dijeni për zëvendësimin e mbështetësit mbi kapacitete. Akoma më tej në rast se BOE ankimues në momentin e marrjes së kërkesës së autoritetit kontraktor, kishte paqartësi lidhur me dokumentacionin që duhet të dorëzonte kishte mundësinë për ti kërkuar sqarime autoritetit kontraktor lidhur me kërkesën e dërguar. Lidhur me sa më sipër arsyetuar, referuar kërkesës së dërguar në SPE nga autoriteti kontraktor, kërkesë e cila referon vendimin nr. 1317/2025, datë 24.09.2025 të Komisionit të Prokurimit Publik, i cili në mbështetje të pikës 2 të nenit 30 të LPP-së është detyrues dhe administrativisht përfundimtar dhe në kushtet kur në pjesën arsyetuese të tij pikën III.2.10 përcaktohet qartësisht se autoriteti kontraktor duhet ti kërkojë operatorit ekonomik zëvendësimin e mbështetësit në kapacitete, Komisioni gjykon, se me dërgimin e kërkesës në SPE duke cituar vendimin e KPP-së autoriteti kontraktor ka përmbushur detyrimin ligjor të parashikuar në nenin 84 pika 4 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. Në kushtet kur autoriteti kontraktor ka dërguar kërkesën në SPE, ka cituar në mënyrë eksplicite vendimin e KPP-së, vendim i cili është administrativisht përfundimtar, Komisioni gjykon, se operatori ekonomik ka qënë në dijeni të

plotë të detyrimit për të zëvendësuar mbështetësin, në përputhje me vendimin e KPP-së. Duke referuar në përmbajtjen e kërkesës së dorëzuar, citimi i vendimit të KPP-së është bërë në kontekst të zbatimit të këtij vendimi nga ana e autoritetit kontraktor, në këtë mënyrë edhe pse kërkesa nuk përmend togfjalëshin “zëvendësimin e mbështetësit”, përmbajtja e saj dhe referenca në një vendim i cili në mënyrë të shprehur përcakton detyrimin e autoritetit për të kërkuar zëvendësimin e mbështetësit, ka për qëllim informimin e operatorit ekonomik për të zëvendësuar mbështetësin në përputhje me vendimin e KPP-së. Kërkesa e dorëzuar nuk mund të interpretohet në mënyrë të izoluar, por duhet të interpretohet në harmoni me vendimin të cilin ajo citon. Akoma më tej vetë BOE ankimues në ankesën me nr. 2912/2025, datë 19.10.2025 pranon që ka marrë në SPE kërkesën për dorëzim dokumentacioni në të cilën citohet vendimi i KPP-së, si dhe në kushtet kur operatori ekonomik kishte dijeni që në mbështetje të ligjit dhe rregullave të prokurimit publik, si dhe vendimit të KPP të sipërpërmendur kishte të drejtën e zëvendësimit të operatorit në kapacitetet e të cilit do të mbështetej, në momentin e marrjes së kërkesës për dorëzim dokumentacioni mund ti kërkonte sqarime autoritetit kontraktor. Komisioni gjykon, se autoriteti kontraktor, ka detyrimin që në zhvillimin e procedurave të prokurimit të zbatojë me përpikëri të gjitha parashikimet ligjore, më qëllim mosdiskriminimin dhe trajtimin e barabartë të operatorëve ekonomikë, ashtu nga ana tjetër edhe operatori ekonomik ofertues ka detyrimin që me dokumentacionin e dorëzuar të provojë që përmbush kërkesat e autoritetit kontraktor. Sa më sipër arsyetuar Komisioni gjykon, se për sa kohë, nga ana e autoritetit kontraktor janë respektuar të gjitha hapat procedurale, të parashikuara në ligj, skualifikimi i operatorit ekonomik ankimues, për arsyen e mësipërme është i drejtë.

Sa më sipër pretendimi i BOE ankimues nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues për kundërshtimin e veprimeve procedurale të autoritetit kontraktor për mos njoftimin në SPE se për këtë procedurë prokurimi kanë filluar afatet e ankimit, Komisioni gjykon se, për sa kohë ankesa e dorëzuar nga BOE ankimues me nr. 2912/2025 prot, datë 19.10.2025 është dorëzuar brenda afateve ligjore, nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “*Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik*”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e BOE “Viante Konstruksion” SHPK dhe “Kegli-Duri” SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr REF-36522-01-31-2025, me objekt: “Blerje Inerte”, me fond limit 161,080,000.00 (njëqind e gjashtëdhjetë e një milion e tetëdhjetë mijë) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 05.03.2025, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Pergjithshme e Rrugeve dhe Ndriçimit Publik Tirane.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Ngarkohet zyra e financës, të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në buxhetin e shtetit të tarifës financiare të paguar nga BOE “Viante Konstruksion” SHPK dhe “Kegli-Duri” SHPK.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fioorent Zguro

